

Nr. Prot.  
Nr.Dok.202300599/7

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2024

**Lënda: Rekomandim për përfshirjen e sëmundjes "celiac" në kapitullin e sëmundjeve gastro-hepatologjike të Udhëzimit të përbashkët nr.21, datë 07.10.2016, të Ministrave të Mirëqenies Sociale dhe Shëndetësisë "Për miratimin e kriterëve të vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot"**

## MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**TIRANË**

Të nderuar

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), bazuar në pikën 1, të nenit 60, të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, (ligji nr.8454/1999) mori në shqyrtim ankesën e shtetasit Defrim Kore.

Shtetasi Kore është babai i dy fëmijëve me inicialet M.K., dhe E.K., të cilët vuajnë nga sëmundja e *celiac* (intolerance ndaj glutenit). Kjo sëmundje kërkon një trajtim specifik ushqimor që ka një kosto prej 15 000 lekë në muaj (pesëmbëdhjetë mijë lekë). Fillimisht, vajzat e tij janë trajtuar nga programet e mbrojtjes sociale (*pagesa në cash të aftësisë së kufizuar*), ndërsa aktualisht me aplikimin e reformës së re, **të zbatimit të skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar ato janë përjashtuar nga programi i mbrojtjes sociale, (pagesat në cash të aftësisë së kufizuar).**

Bazuar në shkronjën "b", të nenit 19, të ligjit nr.8454/1999 AP-ja filloi hetimin administrativ duke kërkuar informacion zyrtar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) lidhur me përjashtimin e dy

fëmijëve me inicialet M.K., dhe E.K., të cilët vuajnë nga sëmundja e *celiac* nga programet e mbrojtjes sociale<sup>1</sup>.

Në komunikimin zyrtar, MSHMS-ja na ka bërë me dije se “...Nga janari i vitit 2023, po aplikohen kritere të reja vlerësimi, të veçanta për fëmijët dhe të rriturit. Procesi i vlerësimit realizohet me ekipe multidisiplinare, duke u bazuar në nevojat shëndetësore e sociale të individit, për të siguruar pjesëmarrjen e tij të plotë në shoqëri. Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar për të Rritur dhe Fëmijë janë përgatitur nga një grup mjekësh të specialiteteve të ndryshme, nga më të mirët në fushat përkatëse dhe kryesisht shefat e shërbimeve të spitaleve universitare. Këta udhëzues janë miratuar si një paketë koherente kriteresh, bazuar në modelin e dhjetë të Klasifikimit ndërkombëtar të Sëmundjeve (të njohura si ICD-10) si edhe sistemin e kodifikimit dhe të cilësorëve të Klasifikimit Ndërkombëtar të Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit për të Rritur dhe Fëmijë (të njohur si ICF) si një klasifikim i Strukturave Trupore, Funksioneve Trupore, Aktiviteteve dhe Pjesëmarrjes, Barrierave dhe Lehtësuesve Mjedisorë. Udhëzuesit e Vlerësimit Bio-Psiko-Social të Aftësisë së Kufizuar për të Rritur dhe Fëmijë janë hartuar mbi bazën e diagnozave ekzistuese, duke riformuluar dhe ristrukturuar kriteret mjekësore në mënyrë që të përshtaten me skemën e re organizative, si edhe për të siguruar që kriteret e reja janë funksionale dhe i përgjigjen si zhvillimeve në shëndetësi, ashtu edhe zhvillimeve ndërkombëtare të fushës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar. Diagnoza “Celiac”, nga e cila vuajnë fëmijët M.K. dhe E.K., nuk është e përfshirë në kapitullin e sëmundjeve Gastro-Hepatologjike sipas Udhëzuesit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Fëmijë. Gjithashtu, MSHMS-ja e ka trajtuar rastin e shtetasit Kore dhe ju ka informuar nëpërmjet Platforës së Bashkëqeverisjes “Shqipëria që duam”.<sup>2</sup>

Për sa më sipër, AP-ja konstaton se ndryshimet ligjore të kryera me qëllim zbatimin e reformës të ndërmarrë nga Qeveria Shqiptare për zbatimin e skemës bio-psiko-sociale të aftësisë së kufizuar në të gjithë qarqet e vendit kanë përjashtuar nga skema e pagesave në cash të aftësisë së kufizuar të dy fëmijët me inicialet M.K. dhe E.K. Kjo, si rezultat i mospërfshirjes së diagnozës (sëmundjes) “Celiac”, në kapitullin e sëmundjeve Gastro-Hepatologjike miratuar me Udhëzuesit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Fëmijë, sëmundje e cila ka qënë e përfshirë në listën e sëmundjeve që

---

<sup>1</sup> Shkresa zyrtare me nr.K5/D2-2prot., datë 3.7.2023 të institucionit të Avokatit të Popullit

<sup>2</sup> Shkresa zyrtare me nr.2631/1prot., datë 11.10.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

përfitonin pagesën e aftësisë së kufizuar<sup>3</sup>. Në këtë mënyrë, është krijuar një problem me parimin e sigurisë juridike.

E drejta për një proces të rregullt ligjor (fair trial) është një e drejtë kushtetuese. E afirmuar nga dy paragrafët e nenit 42 të Kushtetutës<sup>4</sup>, ajo konsiston në dy aspekte kryesore: në mbrojtjen e të drejtave të shtetasve dhe në detyrimin e organeve të pushtetit publik për t'i respektuar këto të drejta gjatë proceseve ligjore dhe administrative. Një nga elementet më esenciale të parimit të shtetit të së drejtës është ai i sigurisë juridike, i cili, ndër të tjera ka si kërkesë të domosdoshme faktin që ligji në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij, në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qartë, të përcaktuar dhe të kuptueshëm. Nga ana tjetër, si standarde kryesore në kuptimin material të parimit të sigurisë juridike konsiderohen moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet ligjore në fuqi, duke përfshirë rastet kur situatë faktike është e pandryshuar.

Njerëzit me sëmundjen *celiac* duhet të konsumojnë produkte specifike pa gluten. Kur flasim për produkte specifike pa gluten, i referohemi atyre që janë bërë posaçërisht për njerëzit me këtë sëmundje. Një familje me një person *celiac* mund të rrisë shpenzimet e saj në shportën e blerjeve me pothuajse 100 € në muaj në krahasim me një familje tjetër që nuk ka asnjë *celiac* në mesin e anëtarëve të saj<sup>5</sup>. Edhe pse disponueshmëria e këtyre ushqimeve është rritur ndjeshëm në dekadën e fundit, çmimi i këtyre produkteve është ende shumë i lartë. Në shumicën e vendeve europiane, por jo vetëm, personat që vuajnë nga sëmundja *celiac* marrin pagesa ose përfitojnë incentivë të tjerë ekonomikë për të përballuar këtë aftësi të kufizuar<sup>6</sup>.

Konkretisht, disa shembuj të vendeve europiane:

- në Bullgari, pacientët me sëmundje *celiac* kanë të drejtën e përfitimit të 10-12 pako në muaj miell pa gluten plus pagesës në cash (ndihmë

---

<sup>3</sup> Vendimi nr.396, datë 28.06.2007, I Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale” që është shfuqizuar

<sup>4</sup> Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. 2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

<sup>5</sup> <https://www.aoecs.org/news/survey-on-economic-aid-for-coeliacs-in-europe/>, 22 prill 2022

<sup>6</sup> Po aty, <https://www.aoecs.org/news/survey-on-economic-aid-for-coeliacs-in-europe/>, 22 prill 2022

financiare) për aftësinë e kufizuar 50% deri në 70% të sëmundjes *celiac* në masën prej 125 euro në vit;

- në Finlandë, *pagesë në cash* për aftësinë e kufizuar në masën prej 95 euro në muaj për fëmijët me *celiac* nën moshën 16 vjeç. Gjithashtu, mbi këtë moshë pacientët me *celiac* fillojnë aplikimin për ndihmë sociale për t'u përfshirë në skemën e mbrojtjes sociale.
- në Greqi, *pagesa në cash* për aftësinë e kufizuar pacientët me sëmundje *celiac* në masën 100 euro në muaj për të rriturit dhe deri në masën 150 euro në muaj për fëmijët të sëmurët me *celiac*. Kjo pagesë duhet të justifikohet me vërtetimin e blerjes së produkteve pa gluten, diagnozën mujore, së bashku me analizat që vërtetojnë ekzistencën e sëmundjes<sup>7</sup>.

Neni 1, i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar e OKB-së, ratifikuar nga shteti shqiptar, parasheh “*Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë*”<sup>8</sup>.

Ndërsa, sëmundja *celiac* është një sëmundje kronike që bazohet kryesisht në një intolerancë gjatë gjithë jetës ndaj proteinës gluten ose nënfraksionit gliadin (përbërës i glutenit). Në rastin e sëmundjes *celiac*, opsioni i vetëm efektiv i trajtimit është një dietë strikte e përhershme pa gluten. Kjo lejon rindërtimin e vleve të zorrëve.

Pra, të sëmurët me *celiac* kanë dëmtime të një prej organit të aparatit të tretjes gjatë gjithë jetës dhe për të qënë pjesë e shoqërisë ata duhet të ushqehen me një dietë strikte pa gluten. Heqja dorë e menjëhershme nga gluteni ka përparësinë më të lartë të sëmundshmërisë.

Bazuar në përgjigjen zyrtare të sipërcituar AP-ja i kërkoi informacion shtesë MSHMS-së lidhur me vënien në dispozicion të kopjes të aktit nënligjor (Udhëzuesit të Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Fëmijët) dhe Raportit të Vlerësimit të Ndikimit të këtij projektaktit tek të drejtat e fëmijëve<sup>9</sup>.

<sup>7</sup> Po aty, <https://www.aoecs.org/news/survey-on-economic-aid-for-coeliacs-in-europe/>, 22 prill 2022

<sup>8</sup> ligj nr. 108/2012 “Për ratifikimin e konventës së OKB-së "Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara"

<sup>9</sup> Ndryshimet ligjore të kryera në vitin 2018, Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 11.04.2018 “Përdisa shtesa e ndryshime në Vendimin Nr. 584, datë 28.08.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar”; prezantuan konceptin e vlerësimit të ndikimit,

Në përgjigjen zyrtare MSHMS-ja informoi AP-në se kriteret për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar tek të rriturit dhe fëmijët në zonat pilot janë miratuar me Udhëzimin nr.21, datë 07.10.2016 (Udhëzimi nr.21/2016) të cilat i gjeni të publikuara në Fletoren Zyrtare nr.225, datë 22.11.2016 në linkun përkatës<sup>10</sup>. Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA) sqarojnë se ky instrument është miratuar me Vendimin Nr. 197, datë 11.04.2018, të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Vendimin Nr. 584, datë 28.08.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar” (Vendimin Nr.584/2008). Pra, nuk ka qenë i aplikueshëm në kohën e miratimit të kriterëve të vlerësimit bio-psiko-social, të cilat janë miratuar në vitin 2016<sup>11</sup>.

Prej vitit 2018 në Shqipëri është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave përdorimi i RIA (Raporti i Vlerësimit të Ndikimit) që është një instrument i ngjashëm por për nga natyra më i përgjithshëm se Instrumenti i Vlerësimit të Ndikimit të Drejtave të Fëmijëve (CRIA)<sup>12</sup>. RIA është një instrument vlerësimi që përdoret për analizimin e impaktit të një politike apo akti ligjor në të drejtat e fëmijës. RIA përdoret dhe në vlerësimin e mëpasshëm (*ex-post*), kur një politikë ose ligj është miratuar dhe ka për qëllim të vlerësojë impaktin real të kësaj politike.

Në vlerësim të përgjigjeve zyrtare të MSHMS-së, dhe Udhëzimi nr.21/2016 AP-ja konstatoi se është mbështetur në nenin 42/3, të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” (ligji nr.9355/2005) dhe Vendimin nr. 431, datë 08.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”(vendimi nr.431/2016). Ligji nr. 9355/2005, është shfuqizuar në tërësi nga ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar

---

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit (RIA) për aktet ligjore dhe nënligjore Udhëzimi i Vlerësimit Bio-Psiko-Social për Fëmijët si akt nënligjor që përcakton sëmundjet mbi bazën e të cilave përfitohet e pagesa në *cash* ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën dhe mirëqenien e fëmijës. Në fazën e përgatitjes së këtij projektakti, strukturat teknike të institucionit iniciues në bashkëpunim me strukturën juridike duhet të kenë kryer vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektaktit, ku duhet të përfshihen shpjegime për qëllimin e objektivat e projektaktit, përputhshmërinë me politikën relevante, parashikimet dhe masat që kanë të bëjnë me zbatueshmërinë, shpenzimet buxhetore, efektet financiare të pritshme.

<sup>10</sup> <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2016/10/07/21/548d32d9-26b3-446c-b399-03d01ece81b8>

<sup>11</sup> Shkresa zyrtare me nr.2631/4prot., datë 16.11.2023 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

<sup>12</sup> Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 11.04.2018 “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin Nr. 584, datë 28.08.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar”;

(ligji 57/2019). Sipas pikave 1 dhe 2 të nenit 31 të ligjit të ri nr.57/2019 pagesa e aftësisë së kufizuar bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave dhe aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, do të zbatohen deri në nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Bazuar në shkronjën “c” të nenit 30, të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” është miratuar Vendimi nr.722, datë 11.11.2019, i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”. Miratimi i këtij vendimi i hapi rrugë zbatimit të reformës së rivlerësimit të aftësisë së kufizuar në Shqipëri. Në thelb të saj është zbatimi i një sistemi të ri të vlerësimit sipas vlerësimit bio-psiko-social.

Në historikun e finalizimit të kësaj reforme, në mënyrë të përmbledhur po prezatojmë aktet ligjore dhe nënligjore që kanë ndikim tek fëmijët me aftësi të kufizuar si vijon:

<b>Aktet ligjore dhe nënligjore</b>	<b>Analizë e karakteristikave kyçe që kanë ndikim te fëmijët me aftësi të kufizuara</b>
Vendimit nr.182 datë 26.02.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve të procedurave e dokumentacionit për vlerësimi dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal” të ndryshuar.	Vlerësimi i aftësisë së kufizuar mbështetet në procedurat e parashikuara në këtë VKM, që përcakton edhe grupet kryesore përfituese, bazuar në listën e diagnozave që përfshijnë aftësitë e kufizuara. Ky vendim kodifikon vlerësimet mbështetur në diagnozat mjekësore ICD 10 dhe DSM-IV, që duhen rikonfirmuar çdo vit për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve dhe pagesave për aftësinë e kufizuar. Këto përmirësime kishin si qëllim <b>thjeshtëzimin e rivlerësimit.</b>

<p>Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 8.6.2016 “Për pilotimin e kriterëve të reja për pagesat dhe shërbimet për aftësinë e kufizuar”</p>	<p>Pilotimi i përdorimit të vlerësimit Klasifikimi Ndërkombëtar i Funksionimit, Aftësisë së Kufizuar dhe Shëndetit (KNF) në dy ndarje administrative të Tiranës. Kategorizon përfitimet në bazë të aftësive të kufizuara të lehta, të moderuara dhe të rënda. Parashikon një paketë për mbështetje, që përfshin pagesa të përshkallëzuara për ndihmësit personalë.</p>
<p>Ligji nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”</p>	<p>Paraqet masat ndihmës për individët dhe grupet në nevojë, mbështetur në aftësitë e kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike dhe sociale, përfshirë fëmijët. Mbështetur në këtë ligj, personat me aftësi të kufizuara mbështeten nga: programi i përfitimit të pagesës për aftësi të kufizuara. Vlerësimi i aftësisë së kufizuar bio-psiko-social i jep të <u><b>drejtën një fëmije të kërkojë shërbimet dhe pagesën për aftësinë e kufizuar dhe prindërve të kërkojnë pagesën e kujdestarisë.</b></u></p>
<p>Vendimi nr.722 datë 11.11.2019 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”</p>	<p>Vlerësimi bio-psiko-social për personat me aftësi të kufizuar mbështetja financiare sipas shkallës së sëmundjes dhe kompleksitetit të saj, bëhet nga komisionet e dedikuara, multidisiplinare, të cilat kanë në përbërje figura profesionale mjekë dhe punonjës socialë. <u><b>E drejta e fëmijës për të përfituar pagesë dhe shërbime të integruara.</b></u></p>

Duke vlerësuar miratimin e akteve ligjore të sipërcituara në përputhje Vendimin Nr. 584/2008; referuar dhe periudhës kohore të miratimit të këtyre akteve ligjore dhe nënligjore AP-ja konstaton se tashmë duhet të realizohet

vlerësimi i mëpasshëm (*ex-post*), bazuar në RIA me qëllim që të çmohet nëse opsioni i zbatuar ka zgjidhur problemin e përcaktuar dhe ka arritur qëllimet e variantit të preferuar bazuar në interesin më të lartë të fëmijës<sup>13</sup>.

Për sa më sipër, AP-ja konstaton se synimi i reformës konsiston në përmirësimin e cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara, ku çdo fëmijë dhe/ose i rritur me aftësi të kufizuara në mënyrë progresive do të kenë qasje dhe do të përfitojnë nga pagesat dhe shërbimet sociale, shëndetësore, arsimore, të formimit profesional dhe punësimin, të një cilësie më të lartë dhe të integruara përmes skemave të mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Ndërsa, hartimi i kriterëve të reja për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar ka si qëllim përmirësimin dhe plotësimin e kriterëve ekzistuese.

Bazuar në rastin konkret, miratimi i kriterëve të reja për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar kanë cënuar të drejtën e fëmijëve me inicialet *M.K. dhe E.K.*, për të përfituar pagesa dhe shërbime integrale.

Institucioni i Avokati i Popullit, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

### **REKOMANDON;**

- Marrjen e masave për përfshirjen e sëmundjes *celiac* në kapitullin e sëmundjeve gastro-hepatologjike sipas Udhëzuesit të Vlerësimit bio-psiko-social.
- Marrjen e masave për vlerësimin e mëpasshëm (*ex-post*), të reformës së pagesave në *cash* bazuar në vlerësimin bio-psiko-social me qëllim vlerësimin e impaktit real të saj tek të drejtat e fëmijëve bazuar në<sup>14</sup>dhe metodologjinë e vlerësimit të ndikimit.
- Marrjen e masave për trajtimin e dy fëmijëve me inicialet *M.K. dhe E.K.*, nga programet e mbrojtjes sociale duke i'u ofruar një paketë shërbimesh sociale (paketë ushqimore) për të përballuar kostot e trajtimit të sëmundjes *celiac*.

<sup>13</sup> <https://www.kryeministria.al/wp-content/uploads/2022/06/RIA-Metodologjia.pdf>

<sup>14</sup> Vendimin Nr. 197, datë 11.04.2018 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa e ndryshime në Vendimin Nr. 584, datë 28.08.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar”



Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave AP-ja u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin!

**K O M I S I O N E R**

**Olta ALIAJ**